




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME / OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

16/07/2024

02/784/1

ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga takimi i parë publik me qytetarë për Raportin e Punës së kryetarit të komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, e mbajtur më 28 qershor 2024, në ora 15:00, në Sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, drejtorë komunalë, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

**Qemajl Aliu:** Përvendetje për të gjithë juve qytetarë të nderuar, asambleistë, kolegët nga administrata e komunës sonë, ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim, falënderoj edhe bashkëpunëtorët që janë prezent këtu, pa të cilët këto projekte dhe këto punë nuk do të ishin implementuar. Para jush sot do të prezantoj raportin gjashtë muaj, pra nga muaji janar deri qershor të këtij viti, ku në këtë prezantim të shkurtër do të prezantojmë disa nga projekte kryesore që bashkarisht me ekzekutivin, më punonjësit e administratës por edhe me legjislativin dhe bashkëpuntorët i kemi quar përpresa. I falenderoj të gjithë, duke filluar edhe nga drejtorët, përkrahjen që e kemi marr në asamble, e po ashtu punë të shkëlqyer kanë bërë edhe punëtorët e administratës të cilëve ë janë mirënjohës, e normal gjithmonë shumë mirënjohës qytetarëve të Komunës së Shtimes, e ne po mundohemi që besimin që n'a kanë dhënë, t'ua kthejmë më punë të mira.

Ju e dini, që për shkak të kushteve meteorologjike dhe menagjimit të financave, punët në teren fillojnë dikur nga fundi i prillit ose fillimi i muajit maj dhe ky raport gjashtë muaj i fillimvitit përmban më pak projekte se sa raporti i gjashëmujorit të dytë.

Edhe pse është vetëm gjashtëmuajori i parë, punë janë bërë shumë, por janë edhe shumë punë për tu bërë e që do të bëhen.

Pasi t'a përfundoj prezantimin e raportit, mund të bisedojmë dhe të shtroni pyetje lirisht, por mund të jepi edhe sygjerime e vërejtje.

Motoja e jonë ishte 'Shtimja urbane' e cila edhe vazhdon të jetë e që po mundohemi përmes projekteve konkrete qytetin e Shtimes t'a zhvillojmë e t'a bëjmë një qytetet urban.

Jemi shumë të lumtur dhe singerish krenar sepse që në vitin e dytë të qeverisjes sonë kemi arritur ta fitojnë grantin e performancës. Ky grant është një çmimi i cili ndahet për komunat që performojnë më së miri, e komuna jonë është një nga ato komuna që ka performuar më së miri, e cila ka nienagjuar më së miri si në aspektin ligjor por edhe në atë të efikasitetit dhe menagjimit të

buxhetit. Prandaj si efekt i kësaj qeverisje të mirë, që e kemi bërë bashkarisht, komuna jonë e ka përfituar këtë çmim dhe kemi fitur rreth 400 mij euro më shumë për qytetarët e komunës sonë.

Pra, puna e mirë, përveq që vlerësohet me një mirënjojje, me një dokument, vlerësohet edhe me një shumë që realisht nuk është e pakët, të cilat do ti orjentojmë kryesisht në ndriqimin publik në teritorin e komunës sonë. Rreth 400 mij euro, ne kemi vendos ti investojmë në ndriqimin publik si në qytet por edhe në fshatra.

Sa i përket buxhetit, është 10.9 milion euro për këtë vit, këtu është llogaritur edhe granti që e kemi përfituar nga granti i performancës por edhe nga të hyrat vetanake që ishin 300-400 mij euro më shumë, kjo tregon që qytetarët e Komunës së Shtimes kanë zell për të paguar taksa dhe tatimet më shumë dhe kjo përkthehet në një vlerësim që i bëjnë punës sonë dhe një besim që kanë krijuar në qeverisjen tonë transparente, parimore dhe të drejtë, për të cilën u jemi mirënjoës dhe do të mundohemi që këto taksa t'ua rikthejmë me projekte dhe punë që janë prioritare dhe që ndikojnë direkt në përmirësimin e jetës së tyre.

Mund ta përmendim edhe institutin GAP, është një nga indikatorët kryesorë të punëve të komunave, ku Komuna e Shtimes sipas këtij instituti 98% të buxhetit për shpenzime kapitale i ka realizuar në vitin 2023. Jemi kranarë që jemi në mesin e 5 komunave që kemi arritur këtë sukses.

Ju e dini që një nga zotimet tonë, që nga fillimi i mandatit para qytetarëve të komunës sonë ishte që Memoriali i Masakrës së Reçakut nuk është në gjendjen që e meriton për shkak të përmasës që ka patur në historinë tonë më të re, për shkak të kthesës historike që ka patur kjo ngjarje dhe jemi duke punuar që këtë memorial, menjëherë pas memorialit të Jasharajve, t'a bëjmë projekt nacional. Me 15 janar të këtij viti, Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Kulturës e ka miratuar si projekt nacional të dytë pas atij të Jasharajve.

Shumë shpejt pra do t'a kemi një kompleks me përmasa kombëtare, sepse ne e dimë që si komunë nuk kemi fuqi të bëjmë kaq investime që ta trajtojmë ashtu siç e meriton ky memorial.

Një vendim i mirë që kemi marrë në kuvend, është edhe ai për nënët lehon, 100 euro për fëmijën e parë, 150 për të dytin, 200 për të tretin, 500 për binjakët edhe ky ishte zotin i yni dhe që në tremujorin e parë të këtij viti kemi filluar me i nda këto mjete, por për çdo vit do ta analizojmë këtë shumë dhe shpresoj që të kemi edhe rritje.

Sa i përket kategorive të dala nga lufta, në pëndim dhe rrespekt e mirënjojje për këto kategori për kontributin që kanë dhënë për lirinë e shtetit tonë, ne jemi mundu që t'ua lehtësojmë pak dhe kemi marr vendim që t'i lironjmë nga taksat komunale për regjistrimin e automjeteve për veteranët e UÇK-së.

Po ashtu një nga ngjarjet që është mirëpritur gjatë këtij gjashëmuori të parë të këtij viti ishte edhe funksionalizimi i qendrës së inovacionit përmes një bashkëpunimi që kemi me një organizatë, kemi arritur t'a bashkqfinancojmë një projekt për 150 nxënës më të suksesëshëm nga shkollat filllore, të kenë mundësi të ndjekin trajnime në fusha të ndryshme, që përveq shkollimit bazë të kenë mundësi të zhvillojnë shkathësitë e tyre edhe në fushat ku kanë prirje më shumë.

Ne e dimë që Lumi Shtimjanja është një lumë që thua jse e pëershkon të gjithë teritorin e komunës sonë, është një lumë që e begaton komunën tonë, por herë pas herë na qet edhe dëme për shkak të trajektores natyrale e nuk kemi arritur akoma ta trajtojmë ashtu siç trajtohen shtretërit e lumenjëve

duke e patur parasysh që sidomos fshatrat e rrafshit mund të kenë vërvshime. Ne kemi insistuar nga fillimi dhe kemi trajtuar një fond që shtrati i lumbit të trajtohet ashtu siç duhet dhe i jemi mirënjoës ministrit Aliu për ndarjen e 5 milion eurove për trajtimin e shtratit të lumbit dhe me këto 5 milion euro, që punët do të fillojnë brenda 2 apo 3 javëve, do të trajtohet fillimisht nga pjesa ku hyn dega e lumbit nga Reçaku në Shtime deri në fund të Vojnoscit dhe jemi me shpresë që vitin e ardhshëm do të ndahet edhe një fond tjeter, që të trajtohen edhe dy degët tjera të lumbit Shtimjana, ajo në drejtim të Mollopolcit dhe ajo në drejtim të Carralevës.

Investime kapitale- Unaza e vogël është në prag të përrurimit është në fazën finale. Po ashtu stadiumi i qytetit që vjet kemi bërë një ndërhyrje në platon dhe me bari sintetik të sdatumit, ju kemi kushte me normale sportistëve të komunës tonë dhe përmes një projekti të financuar nga Ministria e Kulturës që është 2.4 milion euro, po punohet me një dinamikë të shpejtuar që ky stadium të bëhet me tribuna.

Asfaltimi i rrugës "17 Shkurti" pritet të përrurohet brenda 10 ditëve të jashtme, punët kanë mbaruar plotësisht; është një rrugë që to të lidhet me segmentin Pjetërshticë, Carralevë, Zborc, Godanc i Poshtëm, Godanc i Epërm dhe do ta nxjerrë në fshatin Gjurkovc, dhe tanë përvaq aksit natyror që ka pasur komuna e Shtimes dhe fshatrat për të kaluar nëpër qendër, tanë trafiku do të ketë shkarkim dhe një pjesë e madhe e qytetarëve mund të kalojnë nga ai aks rrugor.

Asfaltimi i Zonës Ekonomike në Gllavicë, është projekt që do ta lidhë zonën ekonomike me rrugën Shtime-Koshare, projekt me vlerë diku afro 1 milion euro.

Me ministrit Aliu kemi nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi, ku Ministria e Ambientit dhe Infrastrukturës, finoncon disa rrugë që janë shumë të mirëseardhura për komunën tonë. Asfaltimi i rrugës Carralevë-Pjetërshticë-Dugë, ju e dini që fshati Dugë është njëri nga fshrat më të bukura sa i takon reliefit malor në komunën tonë, po që infrastruktura rrugore atje mungon dhe që rruga aktuale që tanë është nuk graviton në teritorin e komunës tonë, ajo në aspektin kadastral del të jetë në zonën e Suharekës dhe kemi kërkesë nga fshatarët e Dugës për asfaltimin e kësaj rruge, do të investohen 500 mij euro dhe ky projekt do të fillon brenda dy muajve të ardhshëm.

Asfaltimi për lidhjen e rrugës "12 Qershori" me rrugën "Elilan Ealker", rrugë kjo që po ashtu do të investohen 500 mij euro, për ta thjeshtuar është rruga e Reçakut, do të lidhet me rrugen "12 Qershori" dhe kjo është ajo që e kemi quajtur Unaza në drejtim të Ferizajt, pra të gjitha veturat dhe makineritë që vijnë nga drejtimi i Prizrenit, ato që kanë orientim të shkojnë në Ferizaj apo anasjelltas, nuk kanë nevojë më të kalojnë mes qytetit, por bëhet shkarkimi përmes kësaj unaze.

Janë asfaltuar shumë rrugë edhe nëpër fshatra të ndryshme, si në Vojnosc 69,641 euro dhe Gjyrkoc në vlerë 49,950 euro.

Përfundimi i asfaltimit në zonën që po i jep fryshtë zhvillimi Komunës sonë, Parkun Teknologjik. me vlerë prej 57,868.53 euro

Asfaltimi i rrugëve në Belinc me vlerë të përgjithshme të investimit 38,242.14 euro,  
Rruga me gjatësi 154 metra është transformuar tërësisht, duke u mundësuar nxënësve qasje më të lehtë dhe më të sigurt drejt Gjimnazit "Naim Frashëri", vlerë të kontratës prej 45,849.50 euro.  
Pas adaptimit të çerdhes në Muzeqinë, po zhvillohen me ritëm të lartë punimet në çerdhen e re që ka marrë formë në Godanc, por do ta rivitalizojmë edhe çerdhen tjeter në qytetin e Shtimes. Brenda këtyre 4 viteve pritet që të funksionalizohen katër qerdhe në komunën tonë.

Biblioteka dhe arkiva e konunës janë projekte shumë të bukura, që është investuar rrith 378 mij euro, që shumica e qytetarëve tanimë i kanë parë, pritet vetëm inventarizimi, që shumë shpejtë do të përfundojnë edhe ato dhe do të jenë në shërbirnë dashamirëve të leximit.

Bursat për studentë, ju e dini që ka qenë edhe zotim e prioritet i yni mbështetja e studentëve. I kemi gjetur 24 bursa nga qeverisja paraprake, ndërsa këtë vit kemi arritur të ndajmë 100 bursa për studentët e komunës sonë, e vitin stjetër do ti bëjmë 120 e ndoshta edhe më shumë.

Një ngjarje e mirë këtë vit ka qene edhe fillimi i vaksionimit të fëmijëve kundër kancerit të qafës së mitrës, vaksinë kjo që në Evropë ka filluar të implementohet vite më parë dhe është fat i mirë që tani kjo vaksinë do të jetë edhe pjesë e kalendarit të vaksinave edhe në Kosovë.

Në fushën e bujqësisë kemi ndarë subvencione janë diku afro 35 mij euro, për fuqizimin e burrave dhe grave përmes serrave dhe laktofrizëve. Ne mundohemi që fondet tonë që i kemi ti bashkërendojmë me organizata të ndryshme që operejnë në Kosovë, në mënyrë që kjo shumë të rritet dhe në adresë të bujqëve tanë të shkojnë sa më shumë subvencione.

Ndërsa sa i takon subvencionimit të klubeve sportive, ne i kemi gjetur rrith 3 mij e 500 euro që janë ndarë nga qeverisjet e kaluara për sportin dhe këtë vit kemi arritur të ndajmë rrith 61 mij euro për sportistët dhe e dimë që nevojat janë më të madha se kaq por kjo është prap një shumë domethënëse në raport me atë që është ndarë në të kaluarën.

Edhe jëtën kulturore jemi munduar ta begatojmë dhe ta ringjallim, fatmirësisht e gëzojmë një objek të mirë, siç është shtëpia e kulturës, e cila ishte e pafunksionalizuar dhe kemi gjetur një varfëri në aspektin kulturor, ajo godinë më shumë ishte përdorur për mbledhje komemorative dhe tubime politike dhe ne kemi arritur që kalendarin e shfaqjeve kulturore dhe edukative ta përbushim, vetëm gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore të këtij viti, janë dhënë 3 premiera, art i prodhuar nga komuna jonë, por gjatë muajve ka pas edhe shfaqje të tjera.

Një nga oremtimet tonë ishte edhe laboratori spitalor në QKMF të Shtimes, i cili është funksional që para një muaji, dhe në vazhdim do ta paisim me aparaturë me moderne por edhe duke e shtuar numrin e analizavë.

Ju e dini që në Komunën e Shtimes, përvos QKMF-së kanë qenë funksionale vetëm edhe dy QMF-ja nëpër fshatra, dhe zotimi ynë ishte që do ti hapim edhe dy qendra të tjera, të cilat veqse kanë egzistuar po nuk kanë funksionuar, ne kemi investuar në to dhc i kemi adaptuar për të qenë objekte bashkohore për QMF.

Ju e dini që kemi ndërtuar edhe parqe të ndryshme në qytet por edhe në fshatra të komunës sonë, këtë vit kemi ndërtuar një në fshatin Godanc i poshtëm dhe të ulët, një në Muzeqinë dhe një në Rashincë ku kanë mungur dhe me këtë trend do të vazhdojmë në secilin fshat që të jetë një prak dhe një kënd i lodrave për fëmijë.

Sa i takon mbështetjes së OJQ-ve, për këto gjashtë muaj i kemi subvencionuar me 23 mij euro. Projekt që është pritur shumë mirë nga viti i kaluar, është ai i kabinave të pritis për autobusë, që këtë gjashtëmuajor kanë vazhduar edhe në fshatrat Muzeqinë, Carralevë, Gjurkovic, Shtime dhe Godanc, projekt ky që do të vazhdon në secilin vendbanim.

Një nga projektet më të mira dhe më inovative, jo vetëm në Komunën e Shtimes, po në gjithë Republikën e Kosovës është hapja e Observatorit dhe Planetariumit Kombëtar të Kosovës, i vetmi në Kosovë që deshti fati të jetë pikërisht në komunën tonë, janë investur diku mbi 310 mij euro nga Ministria e Arsimit, e po ashtu infrastruktura përcjellëse është kryer nga Komuna e Shtimes dhe ju e keni parë që para pak javësh së bashku me ministren Nagavci dhe miqët tanë amerikan që ishin edhe donatorë të teleskopëve më modernë dhe kjo dotë jetë një qendër ekselente për vrojtimin e trupave qiellore nga astronautët dhe nga të apasionuarit e astronimisë nga i gjithë teritori i Kosovës e më gjerë.

Pardje e kemi përvuara edhe një nga kështjellat, kazermat ose kullat që sipas ushtarëve të UÇK-së, eprorëve dhe dëshmitarëve në komunën tonë kishte edhe më herët ushtarë të UÇK-së, por dalja legale dhe vendosja e tyre në një objekt nga Zona e Pashtrikut dhe Zonës së Drenicës në Zonën e Nerodimes ka filluar pikërisht me datë 26 qershor të vitit 1998 në një shtëpi që është dhuruar nga familja Halili në fshatin Rancë, dhe në rderim të kësaj, ne kemi investuar në ringritje të këtij shtabi që është investim i Komunës së Shtimes dhe Ministrisë së Kulturës, vitin e parë të qeverisjes e shturam rrugën dhe këtë vit së bashku me protagonistët e ngjarjes, përfaqësues të veteranëve, familje të dëshmorëve dhe invalidëve parje përvuam së bashku "Shtabin e Rancës" dhe është një nga ngjarjet më të mira.

Një ngjarje tjetër është edhe ngjarja e shpalljes "Qytetar Nderi", të një mikë shumë të rëndësishëm, jo vetëm të Komunës së Shtimes por të gjithë Republikës së Kosovës është avokati Harmut Ganzke, i cili është profesor dhe deputet, person i cili e ka meritur plotësisht këtë çmim për punën që ka bërë për hapjen e dyerive për ne si Komunë e Shtimes, ky person na ka pritur dhe miqësuar me 12 komuna në Gjermani me të cilat kemi një bashkëunim shumë të mirë.

Ju falemnderit shumë! Këto ishin disa nga ato ngjarjet dhe projektet që kemi bërë këto gjatëmuaj të këtij viti, por janë edhe shumë plane e projekte që janë në fazë të punimeve por edhe drejt përfundimit.

Tani, nëse ju qytetarë të rderuar keni ndonjë pyetje ose ide e sygjerime, unë jam i gatshëm t'u përgjigjem.

**Hysen Hoxha (Gjyrkova):** Falemnderit kryetar për këtë prezantim. Unë i kam përcjellur ngjarjet, kam punuar shumë në gurbet dhe jam shumë i kënaqur kur e shoh që keni dëshirë e vullnet për vendin tonë. Si ambientalist që jamë, i shoh shumë biznese që hapësirat para objekteve bizneseve të tyre nuk i mirëmbajnë siç duhet, ato po e shëmtojnë pamjen rreth tyre.

Shoh shumë qytetarë që nga gjyrkofci e davidofci vij në këmb në Shtime, kjo është mirë për shëndet, por rrugës janë ato biznese duhet ta kuptojnë dhe të kujdesen për ambientin para tyre, as hedhja e ujit në rrugë publike nuk është në rregull që shumë herë ndodh nga ana e tyre.

Për ndryshe ju uroj sukses juve kryetar, jeni të ri, vazhdoni të punoni kështu.

**Muhamed Hoxha:** Përshëndetje për të gjithë të pranishin. Nuk dua të zgjatem shumë, por përball sfidave që kemi pas, megjithatë po arrihet që me punë, përkushtim, transparencë, llogaridhënie që Shtimen t'a bëni urbane e si dëshini është edhe buxheti i këtij viti i ndarë nga qeveria e Kosovës.

Dua që t'i paraqes disa nga kërkesat e kahershme të disa grupove nga Shtimja e natyrisht edhe disa shqetësimë të qytetarëve. Më vjen keq që drejtoresha e kulturës nuk është këtu, por sidoqoft është një kërkesë e kahershme e komunitetit të artistëve që Shtimja të ketë dhe të identifikohet me një event, me të cilin identifikohen edhe komunat e tjera, të ketë një festival.

Po ashtu një kërkesë e veteranëve të aktrimit është mundësia e themelimit të teatrit gjysëmprofesionist, kur dihet që Shtimja ka bagazh profesional.

Nga sfera e shëndetësisë, sa u takon barnave esenciale këto dy muajt e fundit sidomos mungojnë për të smuarit kronik kardiovaskular, ju e dini që është piku i verës dhe temperaturat janë ekstrem të larta dhe një numër i madh i qytetarëve kanë nevojë për këto barna, pse po ndodh kjo pasi mjete të konsiderueshme janë ndarë për këtë qështje.

Sa u takon shërbimeve publike ka shqetësimë te sheshi i qytetit dhe para qendrës tegëtare Eli-ab, e dim që faji është i operatorit, por a mundeni të ndërmerrni masa në këtë drejtim.

Një shqetësim tjetër është edhe ndiqimi publik, banorët e rrugës "Muhamet Mustafa", kanë biseduar për këtë qështje edhe me drejtorin e shërbimeve publike dhe ka qenë kërkesë edhe nga një antare e kuvendit komunal dua të pyes se a do të ketë mundësi që të rregullohet kjo çështje.

Një brengë e disa qytetarëve të cilët përballen me një telashe është edhe parkingu i veturave nëpër rrugë e rrugica të lagjeve, kërkohet një shenjëzim zyrtarë dhe të intervenohet.

Edhe një kërkesë tjetër kryetar, respekt për jetën dhe punën e të ndjerës Fahrije Rexhepi dhe pensionimin e Ylber Imerit, pasi jemi në prag të pushimeve verore dhe bashkatdhatarët kanë nevojë për dokumentacion, dëbet që te ofiqaria tanë ka mungesë të stafit, por a do të kompletohet stafi që të jetë sa më efikas.

Falemnderit shumë!

**Qemajl Aliu:** Falemnderit shumë Muhamed për pyetjet. Ka vite që ne jemi në bisedime me drejtorinë e kulturës por edhe me shumë artistë për themelin e një festivali, ka mundësi që vitin e ardhshëm të startojmë me një festival, gjë që i ka munguar deri tash. Sa i takon themelimit të teatrit, unë kam bërë kërkesë në Ministrinë e Kulturës sepse ajo duhet të miratohet nga kjo ministri, pasiqë financimi dhe pagat do të jenë nga ata, ministri i kulturës dhe ministria janë të interesar që të bjënë diçka edhe në ato komuna të vogla që kanë teatro, pasi që ato kanë të punësuar, por nuk prodhojnë art dhe çka kemi bërë ne, e kemi bërë Asamblin "Ilirida" dhe kemi parë që aty po bëhet një punë e jashzakonshme dhe shumë të rinjë po e japin kontributin me pasionin e tyre.

Ndërsa sa i takon pyetjes për atë para Eli-abit, ne jemi në fazën e fundit të kontraktimit të një kompanie për mirëmbajtje dhe me të lidhur kjo kontratë ne menjëherë do të veprojmë.

Po ashtu ndriçimi publik është e njëjtë situatë, ju e dini që llampat e ndriçimit publik e kanë një jetëgjatësi dhe ato duhet të zëvendësohen dhe për këtë është duke u lidhur kontrata që të gjitha

llampat e ndriçimit publik të zëvendësohen. Diku rrëth 500 mij euro do të jetë kontrata për krijimin e ndriçimit të ri në të gjithë territorin e Komunës së Shtimes.

Sa u takon barnave, sistemi shëndetësor funksionon në atë mënyrë që barnat esenciale për të gjitha komunitatit, por edhe spitalet rajonale dhe QKUK furnizohen nga Ministria e Shëndetësisë përmes fondit. Ministria e Shëndetësisë ka pasur probleme me operatorin në lidhjen e kontratës, përndryshe, ne si komunë i kemi gjetur 35 mij euro që i ka ndarë pushteti i kaluar në vitin e fundit, ndërsa ne në vitin e parë të qeverisjes nga 35 mij euro, kemi ndarë 110 mij euro për barna sepse vet vij nga profesioni i injekësisë dhe kam parë nevojën për këto barna. Diku rrëth 156 mij euro kemi lidhur kontratë 2 vjeçare për furnizim me barna nga taksat e Komunës së Shtimes dhe ka më shumë se 10 ditë që barnat në QKMF-të e Shtimes nuk mungojnë, pra tash edhe 2 vitet e ardhshme do të ketë mjaftueshëm barna. Por është një lajm shumë i mirë pëqe qytetarët, ne veqse e kemi lanësuar projektin e një objekti të mrekullueshëm të QKMF-së së re të Komunës së Shtimes dhe po besoj që me hapjen e katër QKMF-ve dhe me ndarjen e fondeve qoftë për paisje, qoftë për barnat që i përmendëm, zotimi ynë për një shëndetësi model edhe për komunitatit tjera do të ndodh në komunën tonë.

Ndërsa në pyetjen tjetër, na ka rastisur që dy veteranë të ofiqarisë shtimjane siç është Ylber Imeri dhe Idriz Hasani, arritën moshën e pensionimit dhe fatkeqësisht edhe zonja Fahrije Rexhepi na pikëlloi me ikjen nga kjo botë në mënyrë të paparalajmëruar dhe të parakohëshme dhe tanjemi në procedurat e rekrutimit të stafit sepse duhet një periudhe e rekrutimit, po shpresojmë që brenda një kohe të shkurtër të kemi mjaftueshëm staf që t'u gjinden edhe mërgimtarëve ndërsa Ylber Imeri, duke e parë nevojën deri në plotësimin e stafit, kemi arritur që t'a kthejmë përkohësisht përmes një kontrate që është e lejuar.

**Muhamed Ademaj:** E falenderoj kryetarin dhe të gjithë të pranishmit sot në këtë takim. Edhe ne jemi të brengosur sa i takon mjedisit dhe mbrojtjes së mjedisit, dihet që shumë qytetarë nuk marrin pjesë osë nuk bëjnë pagesën e mirëmbajtjes për mbeturinat për shërbimet që ofron kompania për pastrim, përderisa mos të kyqen të gjithë qytetarët në pagesën e kësaj tarife, që nuk është shumë e madhe rrëth 6 euro në muaj, atëherë nuk mundemi me e pas një ambient të pastërt në komunën tonë. Jemi dëshmitar të asaj që qytetarët kujdesen për pronën e tyre private, ndërsa në pronat publike gjendja është krejt ndryshe dhe hundin mbeturina. Duhet të krijohet vetëdijësimi te qytetarët që t'a mbrohet ambienti.

Ndërsa te shtyllat e elektrike, kishte qenë mirë që ato të largohen nga vendet ku nuk janë të vendosura mirë por edhe nëpër fshatra, kishte qenë mirë që kabllot të vendosen edhe nën tokë sepse shpesh herë paraqesin rrezik për qytetarët.

**Behar Sejda:** Përrshëndetje dhe i kam disa pyetje për kryetarin. Rrethojat e QKMF-së në fshatin Muzeqinë më shumë gjasojnë me një burg se sa më një institucion shëndetësor. E po ashtu dashta të pyes sa i përket sinjalizimit të rrugëve në qytetin e Shtimes, që me të vërtetë mungojnë shumë, dhe besoj që pas përfundimit të unazës që do të bëhet afër rrugës "Ahmet Shtimja" edhe komunikacioni do të lirohet.

**Qemajl Aliu:** Falemnderit profesor edhe për pyetjet edhe për kontributin tënd si asambleist i neverisjes tonë. Pastërtia ju e dini që është problematikë për të gjithë qytetet, ne kemi trashëguar një gjendje shumë të rëndë, jemi munduar të bëjmë hapa edhe në themelin e një kompanie publike që do ti ulë hargjimet por edhe të jetë më efikase në mirëmbajtjen e qytetit por edhe do të krijojë prespektivë për disa vende të reja të punës, por deri sa të arrijmë atje po mundohemi që me kontrata pra me operatorë të tjérë. Kompania "Pastërtia" ju e dini që është kompani regionale dhe i ka problematikat e vetae nga pak ka edhe ndikime politike që neve si Shtime na hakmirret dhe jemi dëshmitarë, diçka pra që nuk duhet të ndodh. Janë pikërisht ata qytetarë ndoshta që i kanë të ardhurat më mirë, hezitojnë t'a paguajnë dhe kryesisht mbeturinat i hedhin në mënyrë ilegale dhe në pronë publike.

Sa u takon shtyllave elektrike, ku e dini që KEDS është kompani private dhe jemi duke pastur shumë probleme, ata janë rigoroz në mbledhjen e të hyrave për energji elektrike, ndërsa kur të vie puna të investojnë janë më dorështrënguar. Këtë problem e kemi adresuar deri në nivelet më të larta.

Ndërsa në pyetjen tjetër për QMF-në, në Muzeqinë është një nga qendrat më të mëdha që mbulon një teritor mjaft të madh, vitin e ardhshëm do t'i nënshtronhet një konstruksioni si nga mbrenda por edhe hapësirës jashtë dhe besoj që do të trajtohet komplekt që nga shtrati i lumit, oborri i QMF-së, oborri i qerdhës e deri te këndi që do të bëhet një park, pra do të jetë një segment i trajtuar në të gjitha dimensionet.

Sinjalizimi në shumë rrugë dhe rrugica nuk mungon, por ka edhe vende ku mungon dhe jemi në proces të kontratës. Ju e dini që vitin e kaluar kemi bërë sinjalizim, sidomos në qytet por do të punojmë edhe këtë vit sapo të lidhet kontrata.

**Behar Sejda:** Kryetar kur do të hapet dega e Gjykatës Themelore të Ferizajt në Shtime, pasi kjo do të punësonte edhe shumë jurista nga Komuna e Shtimes dhe do të ishte një ndihmesë shumë e madhe.

Pyetja e dytë, kur do të zgjatet orari i barnatoreve që të parktën të punojnë deri në orët e vona.

**Qemajl Aliu:** Sa i takon degës së gjykatës, të jeni të bindur që ndoshta mbi 20 herë për këtë temë jam takuar me ministren e drejtësisë Albulena Haxhiun, por edhe te Këshilli Gjygjësor, kemi dërguar edhe kërkesë zyrtare dhe jam takuar personalisht dhe në këtë aspekt janë shumë skeptik, kanë një strategji që edhe në qytetet e ngjajshme që janë sikurse Shtimja, sipas të dhënave dhe statistikave ato prodhojnë procese gjygjësore të deformiara dhe në provinca është problem për shkak të njojheve dhe afërsive me nda drejtësi të mirëfillt.

Barnatoret deri në orën 2 pas mesnate zakonisht funksionojnë dhe është orari strikt, por nëse ndonjë barnatore nuk i përgjigjet kësaj liste posa kanë njoftuar qytetarët ajo është hequr nga lista dhe është gjobitet, tanë është krijuar njëfar rrëgulli.

Nëse nuk ka pyetje të tjera, unë ju falenderoj se cilin prej jush që ishit sot këtu edhe për kohën edhe për prezencën e juaj.


Mirëupafshim në takimet e tjera!


Mbledhja ka përfunduar në ora 16:25

Procesmbajtës:

Vlora Hyseni


















**LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIMIN PUBLIK TË KRYETARIT TË KOMUNËS SË  
SHTIMES, QEMAJL ALIUT ME QYTETARË**

Shtime, më 28 qershor 2024 (e premte)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Lirije Reshani	Komuna Shtime	
2	Lumini Shkura	Komuna Shtime	
3	Sulzim Nukememi	Sekuriti e shtimes	
4	Gentiana Mehmeti	Komuna Shtime	
5	Shpjetin Rashi	K.K. Shtime	
6	Qazim Asllani	SHTIME	
7	Gjil FEJZULLATI	Komuna Shtime	
8	Bujar Ferati	Komuna Shtime	
9	Abdullah Guic	Komuna Shtime	
10	Abdu Topalli	Komuna Shtime	
11	SHABE ZEKJA	K.SHTIME	
12	Fikire Fati	K.Shtime	
13	Tunja Rushiti	<del>K.K.</del> OKA	
14	Gazmend Aliu	K.K	
15	Bajroshi Rahmani	ZK	
16	Visan Tershani	K.SHTIME	
17	Leunita Ahmeti	K.SHTIME	
18	Besarta Ademaj	K.SHTIME	

19	Muhamed Shadov	Ladov, Fini; Yllaz	<i>Ustha S</i>
20	Ndralim Domiri	-Shtime	<i>Dilekun</i>
21	SHAPIRIM HYSNI	KOMUNA SHTIME	<i>S.F.M</i>
22	FLAMUR MUHADIM		<i>F.M</i>
23	REFKI KADRI U	Rue	<i>R.M</i>
24	SANIE SADIKI	KESHTELZAKS	<i>Zure</i>
25	Alma Haxhija	Oqtetare	<i>Haxhija</i>
26	Qazim Ademaj	Policia e Kosovës	<i>Gjeddaq</i>
27	Muhamed Ademaj	Amdor i kuvendit në Ylli me	<i>Demaj</i>
28	Foolit Bunjaku	Q.P.S.	<i>Bunjaku</i>
29	HYSNI HOKHA	KOMUNA SHTIME	<i>Hoxha H.</i>
30	Skënder Xauti	K. P. S.	<i>Xauti</i>
31	Donika Zeqiri	KOMUNA SHTIME	<i>Zeqiri</i>
32	KADRI EMINI	K.K - SHTIME	<i>Emini</i>
33	Sigjet Brashnari	KOMUNA SHTIME	<i>Brashnari</i>
34	Gëzim HAXHIA	ASAMBLEIST	<i>Haxhia</i>
35	Bardhyl Rushiti	Drejtori	<i>Rushiti</i>
36	Veton Tomasi	DREJTUE	<i>Tomasi</i>
37	KAPRIOT SHABANI	DREJTOR	<i>Shabani</i>
38	Gosart Batrami	DREJTOR	<i>Batrami</i>
39	Peride Rexha	Ud. deputacioni	<i>Rexha</i>
40	ALBANA FAFIU	Drejtorestre	<i>Fafiu</i>
41	PERGJITJA B. EMINI	Drejtori	<i>Emini</i>